



## BURSA PËR KURSIN VEROR TË GJUHËS ÇEKE

Në kuadër të Programit “*Summer Schools of Slavonic Studies 2020*”, Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve e Republikës së Çekisë ofron 2 (dy) bursa për pjesëmarrje në kurset verore të gjuhës çeke për studentët dhe mësuesit shqiptarë që kanë njohuri ose studiojnë gjuhën çeke. Kurset do të mbahen për një periudhë intensive 3-4 javore në 3 nivele (filleshtar, i mesëm dhe i avancuar) pranë Universitetit “Charles” në Pragë në datat 24 korrik – 21 gusht 2020 web: <http://iss.ff.cunni.cz/en/>; e-mail: [iss.praha@ff.cunni.cz](mailto:iss.praha@ff.cunni.cz) dhe pranë Universitetit “Masaryk” në Brno në datat 18 korrik – 15 gusht 2020, web: <http://kabcest.phil.muni.cz/en/study/summer-school/>; email: [eva@phil.muni.cz](mailto:eva@phil.muni.cz). Kandidatët e interesuar për kurset e mësipërme duhet të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Integritit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, brenda datës 25 shkurt 2020, dokumentacionin përkatës sipas listës në vijim:

1. Kërkesën për ndjekjen e kursit veror të gjuhës çeke të firmosur (ku te vendoset adresa dhe kontaktet);
2. Formularin e aplikimit;
3. Kopjen e noterizuar të diplomës ose të ndonjë dokumenti të ngjashëm që vërteton mbarimin e programit të studimit të nivelit I dhe II të studimeve të larta ose pasuniversitare;
4. Kopjen e noterizuar të listës së notave;
5. Vërtetimin nga universiteti përkatës për kandidatët që ndjekin aktualisht studimet universitare/pasuniversitare;
6. Fotokopjen e faqes së pasaportës me të dhënat e identitetit;
7. 2 (dy) fotografi;

Për kurset e mësipërme preferohen kandidatët që kanë njohuri bazë të gjuhës Çeke. Kandidatët e interesuar duhen të jenë mbi moshën 18 vjeç.

Pala çeke përballon shpenzimet për ushqimin, regjistrimin, programin mësimor dhe kulturor, akomodimin, transportin publik brenda qytetit dhe ekskursionet, ndërsa shpenzimet e udhëtimit ndërkombëtar dhe ato të siguracionit shëndetësor do të mbulohen nga vetë pjesëmarrësit e kursit.

Për një informacion më të detajuar për mënyrën e aplikimit dhe të përgatitjes së dokumentacionit, ju lutemi referojuni informacionit sipas linkut të mëposhtëm.:

<http://sdv.msmt.cz/eu-and-international-affairs/summer-schools-of-slavonic-studies?highlightWords=scholarships>

**DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS**